

03-4598/12/01/ferg

Nr. Regj. 6-9163/12

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE- PEJË, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës: Leonora Bajraktari nga Klina, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5 e 6 par. 1.3 e neni 9 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, në bazë të nenit 37, 123, 195,199 e 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt. 21.12.2012 merr këtë :

A K T V E N D I M

-E pandehura: **LEONORA /TAHIR/ BAJRAKTARI**, e lindur me dt.17.04.1980 në fshatin Radavc, KK Pejë, me banim në Klinë, Rr. " Ali Kelmendi" P.N, ka të kryer fakultetin ekonomik, me profesion Zyrtare Kryesore Financiare në KRU- SH.A " Drini i Bardhë" në Pejë, e gjendjes së dobët, e pamartuar, shqiptare, shtetase e Kosovës, më parë e pa dënuar.

Është përgjegjëse.

-Sepse deri me dt. 31.03.2012, si Zyrtare e Lartë Publik, nuk e ka deklaruar pasurin, në atë mënyrë që si Zyrtare Kryesore Financiare në KRU- SH.A " Drini I Bardhë" në Pejë, edhe pse e informuar me kohë nga ana e Agjensionit Kundër Korrupsion, ka lëshuar afatin Ligjor për deklarim të rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2011.

-me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 5 e 6, par. 1, nënpar.1.2, lidhur me nenin 17, par 1.nënpar 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

Andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore, lidhur me nenin 9 të LK-ës

D Ë N O H E T

ME DËNIM NË TË HOLLA në shumë prej **200(dyqind) €**,

Dënimin e shqiptuar në të holla ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, e në të kundërtën ky dënim do t i zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 13 /trembëdhjetë/ ditësh.

Obligohet e pandehura që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej **5 (pesë)€**, në të njëjtin afat sikurse edhe dënimi.

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dërgohet palëve

A r s y e t i m

Agjensioni Kundër Korrupsion në Prishtinë, ka parashtruar Kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr.01-2533/12, e dt.13.07.2012, kundër të pandehurës, me shënime si në dispozitiv, duke kërkuar që e njëjta të shpallet përgjegjëse sipas dispozitave ligjore, nga neni 5 e 6 par. 1.3 e neni 9 dhe të dënohet konform nenit 17 par 1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

Gjykata pasi shqyrtoi Kërkesën dhe të gjitha provat e bashkangjitura sipas detyrës zyrtare, konstaton se përshtet faktik është në kundërshtim me kualifikim juridik të kundërvajtjes dhe bënë rikualifikimin, nga se në rastin konkret kemi të bëjmë

me mosdeklarimin e rregullt vjetor, nga neni 5 e 6, par. 1, nënpar.1.2, lidhur me nenin 17, par 1.nënpa 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e jo me kundërvajtje për shkak të mosdeklarimit të pasurisë, sipas kërkesës të Agjensisë.

Për vërtetimin e gjendjes faktike, Gjykata filloi procedurën kundërvajtëse, me ç'rast dëgjoi të pandehurën, e cila nuk e pranon kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, me arsyetim se asnjëherë nuk është informuar me këtë obligim, deri me dt. 15.08.2012 kur edhe e ka bërë deklarimin e pasurisë.

Kur e njëjta ballafaqohet nga Gjykata me korrespondencën e saj elektronike me zyrtarët e Agjensis, e njëjta e pranon se e ka dërguar listën e zyrtarëve të lart me urdhrin e Kryeshefit Milazim Shatrit personalisht në Agjensi, por se nuk e ka ditë arsyen, por prapë arsyetohet se e ka bërë këtë lëshim për shkak të mos informimi i saj nga askush prej Agjensis apo udhëheqësit e saj.

Në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar Kryeshefi Milazim Shatrit KRU "Drini I Bardhë", i cili deklaron se këtu e pandehura ka qenë e informuar me kohë nga Agjensioni dhe se e njëjta personalisht e ka dërguar listën e zyrtarëve të lartë të Kompanisë dhe se këtë listë nuk e ka dërguar me urdhrin e tij, por me kërkesën e Agjensionit dhe për këtë kërkesë të agjensionit ajo e kishte informuar personalisht..

Gjykata pasi analizoj secilën provë të administruar veç e veç, si korrespondencën elektronike mes të pandehurës dhe AKK-ës të dt. 20.02.2012, deklaratën e dëshmitarit, deklaratën e të pandehurës, si dhe shkresave tjera gjenë se e pandehura e ka kryer kundërvajtjen në fjalë.

Meqë dëshmia e kryeshefit të kompanisë është në përputhje të plotë me korrespondencën elektronike të dt.20.03.2012 në mes të pandehurës dhe Agjensionit gjykata krijoi bindjen se e njëjta ka qenë e informuar me kohë për obligimin e deklarimit të pasurisë, andaj këtyre dëshmive gjykata ia fali besimin e plotë.

Pretendimet e të pandehurës se nuk ka qenë në dijeni dhe nuk është informuar me kohë nga Agjensioni dhe Kryeshefi, nuk qëndrojnë sepse janë në kundërshtim me të gjitha dëshmitë e administruara dhe Gjykata konsideron se është vetëm përpjekje e të njëjtës për shmangie nga përgjegjësia.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit, Gjykata rrethana rënduese nuk ka gjetur, kurse si rrethana veçanërisht lehtësuese pati parasysh faktin se e njëjta nuk ka qenë më parë e dënuar për asnjë lloj kundërvajtje, gjendjen e saj ekonomike të vërtetuar në bazë të deklarimit të pasurisë nga ana e saj, se për herë të parë ushtron funksionin e zyrtarit të lartë që nga dt. 01.08. 2011, andaj të njëjtës i shqipton cenim të zbutur, konform nenit 9 të LK-ës, me bindje se edhe ky dënim do të ndikoj që e pandehura në të ardhmen të mos përsërisë kundërvajtje të këtillë, apo të ngjashme.

Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Pejë

Nr Regj. 6-9163/12, dt .21.12.2012

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi, parashtuesi i Kërkesës dhe e pandehura kanë të drejtë **Ankese**, në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtjet në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate, në afat prej 8 /tetë/ ditësh, pas marrjes së këtij aktvendimi

